Mësimi 3
Jozefi – Në Krye të Egjiptit

Qëllimi
Studjoni Zanafilla 41: Mësoni se si Jozefi përdori aftësitë e tij nga Perëndia për t'u shërbyer njerëzve. Kuptoni se duhet t'u shërbejmë të tjerëve gjithashtu.

Materialet
Mësuesja dhe/ose Koordinatorët sigurojnë që materialet të jenë gati para çdo ore mësimore.

Printoni nga Faqja e Internetit:
- Ndihma Vizive Jozefi në Krye – një për mësuesen
- Fleta e Aktivitetit Jozefi në Krye – një për klasën
- Loja e Tavolinës T'u Shërbejmë të Tjerëve – një për çdo 3-4 nxënës
- Bibla – të mjaftueshme që secili të ketë një
- Stilolapsa/Lapsa/Krejona
- Stikera (për regjistrimin e pjesëmarrjes)
- Grafiku i Pjesëmarrjes
- Gurët e Lojës – një për nxënës (monedha, kopsa ose gurë të lojës së tavolinës)
- Zara – një për çdo lojë të tavolinës

Materiale Opsionale
- Snack: 7 shkopa pretzel ose copa simiteje – të mjaftueshëm për secilin nxënës

Këshilla për Mësuesen
★ Shikoni Mësimin 1 për ide

1) Hyrja në Mësim

Ndërsa nxënësit hyjnë, mirëpritini dhe ndihmojini të gjejnë një karrige për t'u ulur. Falënderojini që kanë ardhur. Regjistroni prezencën.

Pyetini nxënësit: **Çfarë studjuam javën e kaluar rreth Jozefit?** Jozefi interpretoi një ëndërr për Faraonin. Ëndërra paralajmëroi për një zie buke të ardhshme dhe kupëmbajtësi mbajti mend se Jozefi mund të interpretonte ëndërrat dhe Jozefi interpretoi ëndërrën për Faraonin. Jozefi dha një plan të mençur të veprimit për të ndihmuar me parashikimin e zisë së bukës të ardhshme. Ky plan e kënaqi Faraonin dhe meqëse Perëndia ishte me Jozefin – Faraoni e bëri Jozefin guvernator dhe ai u shndërrua nga një i burgosur i thjeshtë dhe i harruar tek njeriu më i rëndësishëm në Egjipt përveç Faraonit!

Sot do të mësojmë se çfarë ndodh gjatë 14 viteve të ardhshëm që Perëndia e paralajmëroi Faraonin se do të ndodhte dhe se si Jozefi u shërbeu njerëzve me mençuri gjatë kësaj kohe.

2) Koha e Mësimit – Jozefi në Krye në Egjipt 10-15 minuta



Jepni Bibla sipas nevojës. Falënderoni nxënësit që sollën Biblën e tyre. Kini gati ndihmën vizive gjithashtu.

Kërkojuni nxënësve të shkojnë tek **Zanafilla 41:39-57** dhe lexoni. Pyesni nëse ka ndonjë fjalë që kishin vështirësi t'a kuptonin dhe shpjegojini.

Diskutoni pyetjet e mëposhtme si rishikim:

Si e shpagoi Faraoni Jozefin për shpjegimin e ëndërrës që Perëndia e lejoi Jozefin t'a interpretojë? Ai e emëroi guvernator dhe i dha një grua! Sa shpejt ndryshuan gjërat për Jozefin! Perëndia e kishte bekuar për vitet që priti me durim në burg.

Sa vjeç ishte Jozefi kur u bë guvernator i Faraonit? 30 vjeç.

Cili ishte plani i Jozefit gjatë shtatë viteve të bollëkut? Të mblidhte grurin.

Çfarë bëri Jozefi gjatë zisë së bukës? Ia shiti grurin atyre që kishin nevojë për të.

Çfarë duhet të bëjmë kur bekohemi me para ose gjëra shtesë nëse përdorim këtë histori biblike si shembull? Të vendosim mënjanë një pjesë të parave për

kohërat kur mund të mos kemi para. Ose vendosni disa ëmbëlsira ose gjëra mënjanë për kohërat kur nuk keni ndonjë ëmbëlsirë ose kur dikush që njihni është në nevojë.

Çfarë mund të bëjmë nëse kemi shumë dhe dikush tjetër ka nevojë? T'u japim nga ajo që kemi!

Sa bij pati Jozefi? Dy bij.

Si quheshin ata? Manasi dhe Efraimi.

Jozefit iu desh një kohë e gjatë për t'u shpëtuar nga skllavëria dhe burgu. Çfarë duhet të bëjmë kur duket se plani i Perëndisë nuk është duke funksionuar? Të kemi durim. Vazhdoni të bëni të mira dhe lutuni. Mos hiqni dorë!

Kur e dimë se po vijnë kohërat e vështira, si duhet të përgatitemi? Të bëjmë atë që mundemi si Jozefi. T'i kërkojmë Perëndisë në lutje që të na ndihmojë. Të besojmë se Perëndia është duke punuar në atë situatë.

Jozefi ishte shumë i duruar në burg – ai ishte plot kujdes, i duruar, ndihmës dhe vazhdoi duke i shërbyer Perëndisë! Perëndia e shpërbleu për këmbënguljen e tij, durimin dhe gatishmërinë për të shërbyer. Mbani mend se disa herë ndodhin gjëra të këqija, por Perëndia do të na ndihmojë përmes tyre dhe ka një plan për ne për të na ndihmuar, për të na shpërblyer dhe për të na bekuar nëse jemi si Jozefi dhe qëndrojmë besnikë!

3) Fleta e Aktivitetit Jozefi në Krye 15-20 minuta

Jepini një fletë secilit nxënës bashkë me krejona dhe lapsa. Lexoni udhëzimet me zë të lartë dhe punoni me aktivitetet së bashku. Për aktivitetin e gjetjes së drithërave, kujtojini se cilat gjëra janë drithëra: gjëra të bëra nga gruri, orizi, elbi, tërshëra, etj.

Lejoni pyetje ndërsa janë duke punuar.


Sundayschoolbiblelessonsforkids.com

Jozefi - Në Krye të Egjiptit

Tabela e Raportit të Shërbimit

Si e vlerësoni veten tuaj kur bëhet fjalë për t'i shërbyer Perëndisë? Përdorni këtë tabelë të raportit për t'ju ndihmuar për punën tuaj për t'u shërbyer të tjerëve! Vendosni një "X" në vendin e duhur.

	Kurrë	Një herë	3-4 herë	Çdo javë
Kam ndihmuar anëtarët e familjes time pa u paguar				
Kam ndihmuar anëtarët e bashkësisë time pa u paguar.				
Kam ndihmuar njerëz që nuk i njoh personalisht.				
Kam punuar jashtë shtëpisë për t'i ndihmuar njerëzit.				
Kam ftuar dikë në adhurim ose në Shkollën e Bibël.				

Rrethoni përgjigjen më të mirë:

Mendoj se jam duke bërë

Me ndihmën e Perëndisë do të vazhdoj të kërkoj mundësi për t'i shërbyer Atij! Do t'a bëj atë këtë javë!

Do të bëj sa më poshtë:

Tabela e raportit të shërbimit: Përgjigjet janë personale, kështu që mund të vendosin një dorë mbi përgjigjet nëse dëshirojnë. Në fund, pyetni për mënyra në të cilat nxënësit mund të shërbejnë këtë javë. Mund t'a plotësojnë atë kur luajnë lojën e tavolinës të shërbimit pas disa minutash.

Gjeni Drithin: Pica (grurë), Cereale (grurë ose tërshërë), Spageti (grurë), Hamburger (grurë në simite), Bukë, Bukë e Thekur dhe Kulaç (grurë, etj.). E vetmja gjë që të mos rrethohet është perimet/frutat.

Gjërat për të Ruajtur: Shembujt përfshijnë: kursimin e parave, lojrave, ëmbëlsirave, etj. Mënyrat se si mund të kursejnë mund të jenë – të ruajnë një pjesë të parave që u jepen, të mos i hanë të gjitha ëmbëlsirat menjëherë, të ruajnë një palë rroba të mira vetëm për në kishë, etj. Mund të duan të kursejnë gjëra për të tjerët që janë në nevojë për t'ua dhënë atyre. Prandaj ruajini ëmbëlsirat për t'i marrë me vete në shkollë dhe për t'ua dhënë të tjerëve. Kurseni rrobat tuaja të vjetra për t'ua dhënë atyre që janë në nevojë, etj.

Perëndia i dha Jozefit aftësinë për të ndihmuar njerëzit. Perëndia ju ka dhënë ju të gjithëve aftësi gjithashtu. Le të mbajmë mend të përdorim aftësitë tona për t'u shërbyer të tjerëve dhe për të kënaqur Perëndinë. Këtë javë lutjuni Perëndisë dhe praktikoni disa nga këto gjëra duke u shërbyer të tjerëve!

4) Opsionale: Loja e Tavolinës Jozefi Duke Shërbyer 10-15 minuta

Përgatitja

Përpara orës mësimore printoni një lojë të tavolinës për çdo 3-4 nxënës. Mblidhni gurë të ndryshëm të lojës si kopsa, monedha ose gurë nga lojëra të tavolinës të tjera – një gur të ndryshëm për secilin nxënës. Kini një zar për çdo lojë të tavolinës. Sigurohuni se nxënësit kanë një laps dhe fletët e tyre të aktivitetit në mënyrë që të plotësojnë mënyrat se si të shërbejnë në fund të tabelës së tyre të raportit të shërbimit.

Aktiviteti

Do të luajmë një lojë të tavolinës. Në fletën tuaj të aktivitetit në fund të raportit tuaj të shërbimit ka një hapësirë për të shkruar disa mënyra se si mund të shërbeni këtë javë. Ndërsa kaloni përmes lojës së tavolinës, zgjidhni 4 që do të përpiqeni t'i bëni këtë javë për t'u shërbyer të tjerëve.

Lexoni udhëzimet në lojën e tavolinës për nxënësit. Sigurohuni se të gjithë kanë nga një laps për të shkruar përgjigjet e tyre në fletën e tyre të aktivitetit. Luajni lojën duke parë mënyrat e shumta se si mund t'u shërbejmë të tjerëve.

5) Lutja e Mbylljes

**Përpara lutjes, sigurohuni se aktivitetet/snack janë pastruar. Pyesni nëse ka ndonjë lutje që nxënësit dëshirojnë të përmendet dhe nëse po, shkruajini për t'i mbajtur mend.

I dashur Perëndi, lutemi që të jemi të dashur dhe plot kujdes si Jozefi dhe të mos hidhërohemi kur na ndodhin gjëra të këqija. Ju falënderojmë që Ju na ndihmoni kur kemi probleme, ashtu siç ndihmuat Jozefin. Le të jemi gjithnjë mirënjohës dhe të mbajmë mend bekimet Tuaja. Le të ndihmojmë dhe t'u shërbejmë të tjerëve. Le të mbajmë mend se është e rëndësishme të kursejmë dhe t'u japim të tjerëve nga ato që kemi.

Lutemi për ata në kishë që janë të sëmurë, të dobët ose kanë vështirësi. Le të jenë në gjendje të kthehen tek ne herën e ardhshme. Ju falënderojmë për ndihmën Tuaj, dashurinë Tuaj dhe që jeni Ati ynë. Në emër të Jezusit, Amen.

6) Snack Opsional: Pretzel ose Copa Simiteje 5 minuta

Të gjithë keni bërë një punë të shkëlqyeshme këtë mëngjes duke mësuar se si t'u shërbejmë të tjerëve ashtu siç bëri Jozefi. Për të na ndihmuar që të mbajmë mend, do të hamë një snack. Jepini secilit nxënës 7 shkopa pretzel ose disa copa simiteje bashkë me kartopiceta. Pyetini: **Çfarë ju kujtojnë këto?** Shtatë vitet e zisë së bukës dhe të bollëkut të parashikuara nga Jozefi.

Kur Faraoni pa ëndërrën, Perëndia përmes Jozefit ishte në gjendje të tregonte kuptimin. Do të kishte shtatë vite të bollëkut dhe shtatë vite të zisë së bukës. Ky snack na kujton grurin që ishte në ëndërrën e Faraonit. Janë si kallinjtë e grurit. Dhe na kujton se Jozefi depozitoi grurin gjatë kohërave të bollëkut.

Perëndia e ndihmoi Jozefin të kishte aftësinë dhe diturinë për të ndihmuar të tjerët. Perëndia i ka dhënë secilit nga ju aftësi dhe dhurata për të ndihmuar të tjerët gjithashtu.

A ka ndonjë pyetje lidhur me historinë e sotme?
Cila ishte gjëja e preferuar që mësuat ose bëtë sot? Pse?
Cilat janë disa nga aftësitë tuaja që mund të përdorni për të ndihmuar të tjerët?

Flisni për rëndësinë që t'u shërbejmë të tjerëve dhe se si Perëndia kënaqet kur e bëjmë këtë.

7) Këngë Opsionale 5 minuta

12 Bijtë e Jakobit
Melodia: Jezusi Më Do

Rubeni, Simeoni, pastaj Levi,
Juda, Dani dhe Neftali.
Gadi, Asheri, Isakari, Zabuloni,
Jozefi dhe Beniamini.

8) Gjëra për të Mbajtur Mend

Falënderoni nxënësit për ardhjen e tyre.
Nxënësit t'i marrin fletët e aktiviteteve me vete.
Sigurohuni që nxënësit të largohen me një person përgjegjës.

Faleminderit që i shërbeni Krishtit në këtë mënyrë!